

BRUKSEL: MBLEDHJE E KOMITETIT TË PËRBASHKËT TË MARRËVESHJES SHUMËPALËSHE PËR KRIJIMIN E ZPEA AAC, mori pjesë në datat 15-16 Tetor në Bruksel në mbledhjen e Komitetit të Përbashkët... **faqe 2**



ZHVILLOHET TAKIMI I 28-TË I FORUMIT TË SIGURISË TË ECAC Në datat 24-25 Tetor 2019, u mbajt në Bruksel, Takimi i 28-të i Forumit të Sigurisë të ECAC, me pjesëmarrës nga AAC... **faqe 3**

NËNTOR 2019 - Botimi XVII

posta ajrore



Buletini mujor i Autoritetit të Aviacionit Civil shqiptar

www.aac.gov.al | info@acaa.gov.al

Tel: +355 4 22 51 220



IN MEMORIAM PROMEMORIE PËR KOLEGUN PËLLUMB HOXHA

Nga Bujar Hazizaj
faqe 4

RAPORTI

PERFOMANCA E KOMPAJNIVË AJRORE PËR PERIUDHËN

SHTATOR - TETOR 2019

Në bazë të të dhënave të regjistruara nga Sektori i të Drejtave të Pasagjerëve në Autoritetin e Aviacionit Civil...


faqe 6

AKTIVITETE

AKTIVITETE TË DREJTORIVË TË AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL GJATË MUJIT TETOR

Në datën 2 Tetor u zhvillua takimi në EUROCONTROL, Bruksel, "2019 - Local Single Sky Implementation (LSSIP)", ku në këtë takim morën pjesë të ftuar nga 100 palë të interesuara nga 41 shtete, plus institucionet evropiane...

faqe 9



RRITJE E NUMRIT TË PASAGJERËVE FLUTURIMET CHARTER ZOTËROJNË 14% TË TREGUT PËR MUJIN SHTATOR

Referuar të dhënave zyrtare të ardhura në Autoritetin e Aviacionit Civil nga Aeroporti Ndërkombëtar "Nënë Tereza", shifrat tregojnë një numër prej **340,282** pasagjerë, të cilët kanë udhëtuar gjatë muajit Shtator për/nga TIA, nga të cilët **48,656** janë pasagjerë të fluturimeve Charter...

faqe 7

BRUKSEL: MBLEDHJA E KOMITETIT TË PËRBASHKËT TË MARRËVESHJES SHUMËPALËSHE PËR KRIJIMIN E ZONËS SË PËRBASHKËT EVROPIANE TË AVIACIONIT

Autoriteti i Aviacionit Civil shqiptar mori pjesë në Mbledhjen e Komitetit të Përbashkët të Marrëveshjes Shumëpalëshe për krijimin e Zonës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit, organizuar në Bruksel, në zyrat e Komisionit Evropian, në datat 15 - 16 Tetor 2019. Në këtë mbledhje ishin prezent përfaqësues të autoriteteve përkatëse të aviacionit civil të shteteve të asociuara në marrëveshje, të palëve aderuese, të shteteve anëtare të BE-së, përfaqësues të EASA-s dhe përfaqësues nga industria e aviacionit. Mbledhja u drejtua nga përfaqësuesi i Komisionit Evropian, Z. Carlos Bermejo Acosta, nga Njësia E2 - Aviacioni/Marrëveshjet Ndërkombëtare, pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme për Transportin dhe Energjinë në Komisionin Evropian. Axhenda e kësaj mbledhjeje u organizua në 4 sesione gjysëm ditore, ku gjysma e parë ishte sesioni plenar dhe pjesa e mbetur do të ndahej në takime dy-palëshe me përfaqësues të vendeve të asociuara, ku u shkëmbye informacion mbi Protokollet përkatëse dhe zbatueshmërinë e tyre.



BRUKSEL: AAC MERR PJESE NË TAKIMIN E RADHËS SË ECAC

Drejtori i Mbikëqyrjes së Sigurisë në Autoritetin e Aviacionit Civil, mori pjesë në takimin e radhës së forumit të sigurisë të ECAC në Bruksel. Në këtë takim u diskutua mbi CASE Project, i cili financohet nga Bashkimi Evropian, për asistencë teknike në fushën e aviacionit civil në Afrikë dhe Gadishullin Arabik, projektet e përmirësimit të kapaciteteve, propozimet rreth Doc 30 të ECAC-ut në fushën e sigurisë.



BRUKSEL: ZHVILLOHET TAKIMI I 28-TË I FORUMIT TË SIGURISË TË ECAC

Në datat 24-25 Tetor 2019, u mbajt në Bruksel Takimi i 28-të i Forumit të Sigurisë të ECAC, me pjesëmarrës z. Erjon Tema nga AAC. Kryetari i organizatës pasi mirëpriti pjesëmarrësit dhe rishikoi përgatitjet e këtij takimi si dhe paraqiti axhendën e përkohshme për familjarizim. Më tej u prezantuan zhvillimet e fundit të ECAC. Kryetari dhe Sekretariati i ECAC azhurnuan takimin për vendimet e lidhura me sigurinë, të marra në DGCA / 68 (PS) (Malaga, 29-31 Gusht 2019).

Një fokus i veçantë iu dha Sigurisë së ATM-së, ku përfaqësuesit e EUROCONTROL dhanë prezantimet e mëposhtme, në mënyrë që të aftësonin pjesëmarrësit për të diskutuar rolin e Ofruesve të Shërbimit të Lundrimit Ajror në sigurinë në aviacion.

- Hyrje në lidhje me EUROCONTROL;
- Siguria e ATM-s si pjesë e Sigurisë së Aviacionit;
- Ekipi Evropian i ATM-ve për Reagimin e Emergjencave të Kompjuterëve.

Gjithashtu u zhvilluan debate lidhur mbi Cyber Security në aspekte të ndryshme, ku u bënë dhe disa prezantime nga Rumania, Turqia dhe Mbretëria e Bashkuar. Shtetet Anëtare të ECAC paraqitën arritjet e tyre kryesore të 2019 dhe prioritetet e tyre të punës për vitin 2020.

Gjatë ditës së dytë të takimit u paraqitën arritjet gjatë vitit 2019 dhe përparësitë për vitin 2020 të Shteteve dhe organizatave vëzhguese.

Kryetarët e Task Forcës të ECAC raportuan mbi zbatimin e Programit të tyre të Punës për vitin



2019 dhe prezantuan aktivitetet e planifikuara për vitin 2020 si vijon për;

1. Task Forcë Materiale Udhëzuese DP / 5
2. Task Forcë Trajnimi - DP / 4
3. Task Force Teknike

Moderatorët e Grupeve të Studimit ECAC i ofruan Forumit një azhurnim mbi zbatimin e Programit të tyre përkatës të Punës 2019 dhe prezantuan aktivitetet e planifikuara për vitin 2020;

1. Grupi studimor për sigurinë kibernetike në aviacionin civil
2. Grupi i studimit për Zbulimin e Sjelljes
3. Grupi i studimit për qentë zbulues të eksplozivit.



AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL



PROMEMORIE PËR KOLEGUN PËLLUMB HOXHA

NGA BUJAR HAZIJAJ



Lajmi se kolegu ynë i nderuar Z. Pëllumb Hoxha, kishte ndërruar jetë në një spital të Tiranës, më datë 19 Korrik 2019, ishte një goditje e vërtetë. Një lajm, që askush prej nesh nuk do të donte ta dëgjonte e aq më tepër ta besonte. Pëllumbi e donte kaq shumë jetën dhe aviacionin civil, sa dukej sikur nuk do kishte pension e jo më vdekje për të. Pëllumbin e njoha rreth 10 vjet më parë, në vitin 2009 kur erdhi nga Aeroporti i Tiranës, për të filluar punë si Menaxher i Kontrollit të Brendshëm të Cilësisë, në shoqërinë ajrore Albanian Airlines ku unë punoja si Menaxher për Burimet Njerëzore. Shpejt u kuptua se drejtuesit kryesor të kompanisë kishin bërë zgjedhjen e duhur.

Si të thuash, kishin gjetur njeriun e duhur për atë vend pune. Ditë pas dite, njohja jonë shoqërore u thellua edhe më shumë dhe kështu si unë dhe kolegët e tjerë patëm rastin të njohim horizontin e dijeve profesionale të këtij njeriu, qartësinë dhe përkushtimin me të cilin ai i trajtonte çështjet, thjeshtësinë e komunikimit dhe modestin e natyrshme. I palodhur për të studjuar, për të folur e ndarë eksperiencën e tij në fushën e aviacionit civil me çdo bashkëbisedues pavarësisht moshës, shpejt, ai arriti të fitoj respektin e gjithë stafit, lidhjet me të cilët vazhdonte ti mbante edhe pasi ishte larguar nga kjo kompani. Rrethanat e jetës na sollën, që me Pëllumbin të takoheshim përsëri në vitin 2013, këtë herë si kolegë në Autoritetin e Aviacionit Civil, ku ai mori detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Mbikqyrjes së Aeroporteve. Në fakt, për të ardhja në AAC, ishte rikthim në institucionin që ai e kishte udhëhequr si Drejtor i Përgjithshëm i DPAC dhe njëkohësisht Zëvendësministër i Transporteve, në vitin 1998. Në vitet 2014-2016, Autoriteti i Aviacionit Civil u bë pjesë e Projektit të Binjakëzimit Nr.2 "Për forcimin e kapaciteteve të AAC", të financuar nga Bashkimi Evropian, me partnerë të rëndësishëm si DGAC Francë dhe të Qendrës së Ekselencës së Aviacionit Civil (RECECA) Rumun. Megjithatë eksperiencën e gjatë të punës në aeroportin e Tiranës, ai përsëri ndiqte me zell të madh komponentët e seksioneve të modulit për aeroporte,

aerodromet, aspektet rrugullatore dhe ato për aktivitetet e mbikqyrjes. Nëse ka të tregues që mund t'i sintetizoj të gjitha karakteristikat e tij të punës, unë do thosha se ishte përkushtimi i tij për të kryer detyrën e ngarkuar. Asnjëherë nuk e kam dëgjuar të ankohet për ngarkesën e punës, por vetëm të shqetësuar se si mund ta bënte atë më mirë. Një tjetër shqetësim për të ishte kalimi, transferimi i eksperiencës së punës tek të rinjtë. Ai donte shumë që të rinjtë e punësuar në AAC të përfitonin nga eksperiencia e tij dhe e kolegëve të tjerë. "Kjo duhet bërë me përkushtim", thoshte ai, pasi Shqipëria nuk ka shkollë apo degë në universitete ku të mësohet për aviacionin civil dhe të përgatitet gjenerate e re. Ne ishim me fat, se u përfshimë herët dhe arritëm të mësonim gjatë punës, se çfarë ishte aviacioni civil dhe tani vetëm duke e ndarë eksperiencën tonë, ne, mund të sigurojmë vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e kapaciteteve njerëzore në këtë fushë".

Një aspekt tjetër i karrierës dhe marrëdhënieve të punës tij ishte ndjeshmëria për vlerësimet që merrte nga kolegët dhe drejtuesit. Ai prekej e madje përlotej, jo se i kishin munguar medaljet dhe dekorimet për vitet dhe kontributet e punës, por e prekte vëmendja që tregohej nga të tjerët për të. Kështu ndodhi kur në një mbrëmje feste të Vitit të Ri 2018, me stafin e AAC, atij ju dha në mungesë, diploma si punonjës i karrierës për përkushtimin e tij. Kur e mori në dorë, pas festës, ai u shpreh, më mirë që nuk isha në atë mbrëmje, se kush e di ç'do më kishte ndodhur. Së fundi zemra e tij kishte shfaqur probleme. Por ai nuk ndaloi, vazhdoi të punoj me përkushtim deri ditën kur ju rëndua dukshëm shëndeti, deri sa u largua përgjithmonë. E sigurtë është, që emri tij do të jetë përkrahë emrave të tjerë të respektuar që punuan dhe kontribuan për krijimin dhe zhvillimin e aviacionit civil në Shqipëri. Për të fituar emrin e mirë në këtë fushë nuk ka nevojë të bësh heroizma, mjafton vetëm të çosh përpara atë që është arritur më me mund e përpjekje nga të tjerët.

Përpos dhimbjes për humbjen e tij, stafi i Autoritetit të Aviacionit Civil ka arsye të krenohet që pati fatin ta njoh dhe të punoj me të!

A E DINI SE...!?

Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë mbulon gjithë komunikimin dhe korrespondencën jashtë institucionit duke qenë pika referuese për të gjitha lidhjet e Autoritetit të Aviacionit Civil me organizmat ndërkombëtar si dhe autoritetet e vendeve të tjera.

Organizatat në të cilat vendi ynë merr pjesë aktivisht janë:

Organizata Botërore e Aviacionit Civil (ICAO), e cila është një agjenci e specializuar e Kombeve të Bashkuara, themeluar më 1944 për të administruar Konventën e Chicago-s mbi aviacionin civil.



Foto nga viti 1944 ku diplomatët nga 54 fuqi të botës në atë kohë hartuan Konventën vizionare për Aviacionin Civil Ndërkombëtar (Konventa e Çikagos) e cila themeloi ICAO-n

ICAO punon me 193 vende anëtare si dhe industrinë për të arritur konsensus në Praktikat e standardet e rekomanduara me synim mbështetjen për një fushë të sigurtë, produktive dhe me qëndrueshmëri ekonomike por dhe përgjegjësi mjedisore.

Këto rekomandime përdoren nga vendet anëtare për të siguruar, se operatorët kombëtar janë konform rregullave dhe standardeve ndërkombëtare.

Kuriozitet: A e dini se? 

Viti 2019 shënoi 75 vjetorin e Konventës së Aviacionit Ndërkombëtar ku ICAO ka qenë zëri i aviacionit civil ndërkombëtar në botë.

ECAC është themeluar në vitin 1955 dhe njihet si Konferenca Europiane e Aviacionit Civil, e cila ka për synim të harmonizojë politikat dhe praktikët e aviacionit civil mes vendeve anëtare por dhe të promovojë zhvillimin e vazhdueshëm të sigurt, produktiv dhe të qëndrueshëm në sistemin e transportit ajror ndërkombëtar.

Shqipëria i është bashkuar organizatës në 1998.

Kuriozitet: A e dini se? 

Çdo vit kjo organizatë ka mbledhjen e radhës speciale në një vend anëtar për të vendosur. Për

vitin 2020, vendi ynë do të mirëpres mbledhjen e radhës, duke e kthyer Shqipërinë në një pikë referimi për aviacionin civil, si dhe duke promovuar turizmin në vend dhe industrinë e aviacionit civil.

EUROCONTROL është një organizatë pan europiane dhe civilo-ushtarake, dedikuar në mbështetjen e aviacionit në Europë me synimin për të arritur vizionin e një qielli të përbashkët europian.

Shqipëria është bërë anëtare në Eurocontrol në vitin 2002.



Pamje nga trafiku ajror i pasqyruar në "Flight Radar" në kontinentin europian

EASA, Agjencia e parrezikshmërisë së Aviacionit të Bashkimit Europian, u themelua në vitin 2002, e cila angazhon mbi 800 ekspert të aviacionit me qendër në Gjermani dhe zyra në Bruksel. EASA mban 32 vende anëtare, ku vendi ynë merr pjesë me statusin e vëzhguesit.

Po çfarë bën EASA? Agjencia është kryeqendra e strategjisë për parrezikshmërinë në Aviacion, me mision të kontribuojë në vendosjen e standardeve më të larta të parrezikshmërisë dhe mbrojtjes së mjedisit në fushën e aviacionit civil.

Kuriozitet: A e dini se? 

Drejtori Ekzekutiv Z. Patrick Ky, i EASA, vizitoi vendin tonë në Shkurt të vitit 2019.



Drejtori Ekzekutiv Z. Patrick Ky, i EASA dhe z. Keri, drejtor i AAC gjatë vizitës vendin tonë në Shkurt të vitit 2019.

RAPORTI I PERFORMANCËS:

PERFOMANCA E KOMPANIVE AJRORE PËR PERIUDHËN SHTATOR - TETOR 2019

Në bazë të të dhënave të regjistruara nga Sektori i të Drejtave të Pasagjerëve në Autoritetin e Aviacionit Civil, për periudhën Shtator - Tetor 2019 rezultojnë se performanca e disa kompanive ajrore për sa i përket vonesave, anulimeve ka qenë si më poshtë:

➔ **ERNEST SPA** gjatë muajve Shtator-Tetor 2019 ka pësuar 26 vonesa në mbi 2 orë dhe 2 anulime. Vlen për tu theksuar fakti, se kompania Ernest Airlines ka numrin më të madh të vonesave për muajin Tetor 2019, për shkak të defekteve teknike të ndodhura (AOG) të avionit dhe për arsye operationale (vonesa në ardhje nga fluturimet e tjera.

➔ **ADRIA AIRWAYS** gjatë muajit Shtator 2019 rezultoi me 21 anulime kjo për shkak të falimentit të shpallur të kësaj kompanie në muajin Shtator 2019.

➔ **BLUE PANORAMA** për muajin Tetor 2019 ka vetëm 1 vonesë në mbi 2 orë për shkak të grevës së kontrollorëve në aeroportet e Italisë.

➔ **WIZZ AIR** gjatë muajve Shtator-Tetor 2019 rezultojnë me 5 vonesa në mbi 2 orë.

➔ **ALBAWINGS** gjatë muajve Shtator-Tetor 2019 rezultojnë me 3 vonesa në mbi 2 orë.

➔ **LUFTHANSA** gjatë muajve Shtator-Tetor 2019 rezultojnë me 2 vonesa në mbi 2 orë dhe 2 anulime.



➔ **BRITISH AIRWAYS** përgjatë muajve Shtator-Tetor 2019 rezultojnë me 1 vonesë në mbi 2 orë dhe 3 anulime.

➔ **AUSTRIAN AIRLINES** përgjatë muajit Shtator 2019 rezultojnë me 2 vonesa në mbi 2 orë.


➔ **ALITALIA** përgjatë muajit Tetor 2019 rezultojnë me 1 anulim për shkak të grevës së kontrollorëve në aeroportet e Italisë

➔ **TRANSAVIA** përgjatë muajit Shtator 2019 rezultojnë me 2 vonesa në mbi 2 orë.



AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

✉ AAC i bën thirrje të gjithë pasagjerëve që kanë plotësuar formularët e ankimit dhe ka kaluar afati prej 6 javësh, që të rikontaktojnë përsëri kompanitë ajrore që kanë patur fluturimin për tu njohur me statusin e fluturimit të tyre. Në rast se kompania nuk i kthen asnjë përgjigje, atëherë të kontaktojnë me sektorin e të Drejtave të Pasagjerit të AAC-së në numrat e telefonit: ☎ **+355 42 381 959 / +355 44 539 959** ose me email tek: **pax@acaa.gov.al** dhe do të marrin asistencën e nevojshme. Për më shumë informacion vizitoni gjithashtu dhe linkun e mëposhtëm:



www.aac.gov.al/te-drejtat-e-pasagjerit




ANALIZA STATISTIKORE

TË DHËNAT PËR NUMRIN E PASAGJERËVE GJATË MUAJIT SHATOR

■ **SHTATOR 2019:** Referuar të dhënave zyrtare të ardhura në Autoritetin e Aviacionit Civil nga Aeroporti Ndërkombëtar “Nënë Tereza”, shifrat tregojnë një numër prej 340,282 pasagjerë, të cilët kanë udhëtuar gjatë muajit Shtator për/nga TIA, nga të cilët 48,656 janë pasagjerë të fluturimeve Charter. Bazuar në të dhënat e mëposhtme në muajin Shtator 2019, kompania Italiane “Blue Panorama” zotëron tregun me 16% të totalit dhe një numër prej 54,459 pasagjerë, pasuar nga Ernest Airlines me 15% të tregut me 49,504 pasagjerë. Fluturimet charter zotërojnë 14% të tregut për këtë muaj. Për sa i përket fluturimeve charter, pjesë e kalkulimit nuk është numri prej 7,438 pasagjerë i kompanisë Pegasus Airlines (20), e cila kryen fluturime charter drejt Antalyas. Pra sëbashku, totali i numrit të pasagjerëve për fluturimet charter është edhe më i lartë, duke zotëruar kështu 15% të tregut me një shifër prej 52,019 pasagjerë.

Grafiku i mëposhtëm pasqyron më qartë fluksin e pasagjerëve që kanë udhëtuar përgjatë muajit Gusht 2019, të ndarë sipas kompanive ajrore në përqindje.




Grafiku 1:

zotërimi i tregut të numrit të pasagjerëve në %, sipas kompanive ajrore që kanë udhëtuar për/nga TIA gjatë muajit Shtator 2019

■ **PËRQINDJET:** Sikurse mund të shihet edhe në grafik, kompanitë që fluturojnë drejt Italisë, si Air Albania, Albawings, Blue Panorama, Ernest S.p.A, Alitalia, zotërojnë përqindjen më të madhe në tregun e transportit ajror për muajin Shtator 2019, me një numër pasagjerësh prej 174,021 dhe 51% të totalit.

■ **SHTATOR 2018** Krahasimisht me muajin shtator të një viti më parë, ku numrat konsistojnë në 125,986 pasagjerë, shifrat janë rritur pasi kompania shqiptare “Air Albania”, ka hyrë në treg me tre destinacione të reja. Nëse do të bënim krahasimin e tre viteve të fundit, trafiku ajror dhe fluksi i pasagjerëve këtë vit, gjatë Shtatorit ka një rritje prej 14% krahasuar me vitin e kaluar.

Grafiku i mëposhtëm jep një informacion të plotë krahasimor për muajin Shtator, të tre viteve të fundit të numrit të pasagjerëve sipas shoqërive ajrore.




Grafiku 2:
Numri i pasagjerëve për muajin Shtator përkatësisht sipas viteve 2017, 2018, 2019 sipas operatorëve ajrorë.

Përsa i përket rritjes/rënies së fluksit të lëvizjes së pasagjerëve për muajin Shtator 2017-2018-2019, vëmë re se rritjen më të lartë në treg e ka kompania Wizz Air, me 140%, krahasimisht me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Duke u pasuar nga Lufthansa, e cila shënon rritje prej 89% të numrit të pasagjerëve krahasimisht me një vit më parë. Gjithashtu rritje kanë edhe fluturimet Charter me 5%.

Grafiku i mëposhtëm paraqet krahasimin e numrit të pasagjerëve në muajin Shtator 2019, kundrejt së njëjtës periudhë të vitit 2018 dhe 2017:



Grafiku 3:
Numri i pasagjerëve për muajin Shtator përgjatë viteve 2017, 2018, 2019



AKTIVITETE TË DREJTORIVE TË AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL GJATË MUAJIT TETOR

Në datën 2 Tetor u zhvillua takimi në EUROCONTROL, Bruksel, "2019 - Local Single Sky Implementation (LSSIP)". Mekanizmi i LSSIP, është një nga shërbimet kryesore të EUROCONTROL, për komunitetin e Air Traffic Management, ku më së shumti në këtë takim morën pjesë të ftuar nga 100 palë të interesuara nga 41 shtete, plus institucionet evropiane. Ngjarja vjetore e LSSIP, siguron një mundësi të vlefshme për të rishikuar përparimin e zbatimit të ATM në Evropë. Rezultatet e këtij mekanizmi raportues, do të përpilohen në një grup të ri të përfshirë në dokumentin që shtetet së bashku me EUROCONTROL, prodhojnë çdo vit në atë që quhet "LSSIP 2019 ALBANIA". Duke siguruar që të gjithë shtetet koordinojnë për të përmirësuar Menaxhimin e Trafikut Ajror në Evropë, mekanizmi i LSSIP-it luan një rol vital duke ofruar një pasqyrë gjithëpërfshirëse për implementimin e paketës SES ndërmjet shteteve të ECAC.

Të interesuarit mbi këtë çështje mund të gjejnë më shumë informacion në linkun më poshtë:
<https://www.eurocontrol.int/news/2019-lSSIP-event-coordinated-and-track-improve-european-atm>



Gjatë takimit që zhvillua ne Bruksel mbi "Local Single Sky Implementation (LSSIP).



Në zbatim të *Udhëzimit Nr. 118, datë 23.10.2012, të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, "Për Miratimin e Rregullores për Mbikëqyrjen e Sigurisë në Menaxhimin e Trafikut Ajror dhe në Shërbimet e Lundrimit Ajror"*, në datat 30 Maj - 5 Qershor 2019, u zhvillua Auditi i radhës pranë Albcontrol, Ofruesit të Shërbimeve të Navigimit Ajror në Republikën e Shqipërisë.

Në vijim të këtij auditi, në datat 14-18 Tetor 2019 u zhvillua auditi i radhës pranë Albcontrol sh.a., i cili ishte i fokusuar në sektorin teknik.

Në këtë audit fokusi ishte si më poshtë:

- Safety Management System,
- Mbikëqyrjen e ndryshimeve,
- kalibrimet, interoperabiliteti dhe sigurinë e software-ve,
- Ngjarjet teknike,
- Shërbimet e kontraktuara.

Gjatë auditit u konstatua se Albcontrol Sh.a menaxhon mirë sistemet e kalibrimeve, interoperabilitetit dhe sigurinë e software-ve. Menaxhimi kryhet me anë të procedurave dhe mirëmbajtja kryhet sipas planeve të rregullta

mujore. Kompetenca e stafit shkon në përputhje me skemën e kompetencës që është miratuar nga AAC. Pjesa më e madhe e gjetjeve të mëparshme janë mbyllur.

